



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo

<http://kk.rks-gov.net/istog/>



Komuna e Istog  
Opština Istok  
Istog Municipality

Tel: 038/200 438 14

---

## KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

---

### P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e katërt e rregullt të Legjislacionit të VIII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: **30.03.2026**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora **10:00**.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

1. Enver Rugova, LDK;
2. Zenel Shatri, LDK;
3. Arianit Selmanaj, LDK;
4. Faruk Kabashi, LDK;
5. Ruzhdi Metaj, LDK;
6. Artë Balaj, LDK;
7. Liridona Lajqi Avdiaj, LDK;
8. Ajshe Imeraj, LDK;
9. Abetare Sutaj Arifaj, LDK;
10. Hajrush Shoshi, LDK;
11. Haki Podrimaj, LDK;
12. Valbona Demaj, LDK;
13. Faik Alushaj, LDK;
14. Bedri Haxhiu, LDK;
15. Ali Nimanaj, PDK;
16. Astrit Hajrizaj, PDK;
17. Kaltrina Arifaj, PDK;
18. Arben Kabashi, PDK;
19. Nexhmedin Balaj, PDK;
20. Lirie Demiraj Sadikaj, PDK;
21. Astrit Bujupaj, VV;
22. Niman Beqiraj, VV;
23. Fjolla Ukaj, AAK;
24. Lulzim Shoshi, L.SH;
25. Valmir Rama, IRDK;

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm Kryetari i komunës Ilir Ferati, Drejtorët e Drejtorive, zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV – Fontana, përfaqësues të OSBE-së (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje)

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejtë në:

<https://www.youtube.com/watch?v=qeGPC6aEuil>

<https://www.youtube.com/watch?v=fWZbAgvTgUU>

<https://www.youtube.com/watch?v=eKXrRWTseil>

Procesverbali

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova. Kryesuesi i Kuvendit- përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje.

**Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës në sallë, prezentë janë 25 të anëtarë të Kuvendit.**

Para se të fillojmë, po i thërras anëtarët të cilët kanë për ta dhënë betimin, e thërras anëtarin e parë Hajrush Shoshi.

**Niman Beqiraj, LVV** - përshëndet të pranishmit, duhet të votohet njëherë rendi i dites se këtu thotë pika e dytë e rendit të ditës, duhet të votohet rendi ditës së pari e pastaj me jap betimin. Sepse ka me ju nënshtruar ligjmerisë.

**Kryesuesi i Kuvendit-** po le t'i nënshtrohet ligjshmerisë, nuk jemi duke bërë ndonjë shkelje. Këta nuk mund të votojnë pa e dhënë betimin.

**Niman Beqiraj, LVV** - ne jemi 22 anëtarë të pranishëm të Kuvendit dhe mund të vazhdojmë sepse ka kourum për të votur rendin e ditës.

**Astrit Hajrizaj, PDK** - përshëndet të pranishmit, kryesues fillimisht duhet të lexohet rendi i ditës dhe të kërkohet nga ekzekutivi dhe nga anëtarët e Kuvendit nëse kanë propozime shtesë pastaj të votohet në terësi rendi i ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit-** po më vjen keq Astrit por kur je bërë ti drejtor , kemi heq shumë me i ndërruar pikërisht për këto. Mos u bëni të paarsyeshëm. Duhet me i marrë logjikisht gjërat.

**Niman Beqiraj LVV-** nuk po të them asgjë ta shkelësh të drejtën tënde as ligjin. Nuk mundesh ti me qit pikën e dytë pa e votuar rendin e ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit-** është dhënie e betimit. Fjalën e ka Arben Kabashi.

**Arben Kabashi, PDK-** kryesues ti e di që kur thirret një mbledhje e Kuvendit thirret zyrtarisht atëherë ti nuk mundesh me e shkel këtë parim as Rregulloren e Kuvendit.

**Kryetari i Komunës-** për Astritin për Arbenin dhe Nimanin procesi i dhënies së betimit është proces politik. Mos tentoni me e kthyer në proces procedural përpos nëse nuk e keni ndërmend me e bllokuar mundësinë e dhënies së betimit të kolegëve tuaj tash prej LDK-së. E njëjta gjë ka ndodhur edhe para katër viteve edhe e dimë se si është proceduar.

**Niman Beqiraj LVV-** unë ju dëshiroj sukses dhe ja uroj mandatin anëtarëve të rinj që kanë me dhënë betimin, unë vetëm po them që Ligji për Vetëqeverisje Lokale thotë fillimisht pyeten anëtarët, pyetet ekzekutivi lexohet rendi i ditës, votohet rendi i ditës pastaj vjen pika parë, e dyta e me radhë, këtë e keni sjellë ju, nëse unë jam duke ta shkel të drejtën ose po bëj politik siç po thua ti, unë të kërkoj falje, por jam për me e respektuar këtë rregull.

**Astrit Hajrizaj PDK-** nëse po dëshironi me u respektuar rendi i ditës ashtu siç e keni sjellë materialin, pse po doni me e përdor politikisht, pse me e kaluar këtë pikë. Pse duhet me e diskutuar aq shumë këtë çështje.

**Kryesuesi i Kuvendit-** të pranishëm i kemi 20 anëtarë të Kuvendit, dhe 5 që janë në pritje për dhënien e betimit 25 anëtarë në total, Floriana Maxharraj ka kërkuar leje është me arsye dhe Ukë Blakaj nuk më ka njoftuar asgjë.

Hap punimet për mbledhjen e katërt të rregullt të Legjislacionit të VIII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Dhënia e Betimit të anëtarëve të Kuvendit të komunës nga radhët e LDK-së
3. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
4. Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2025,
5. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2025,
6. Shqyrtimi i Raportit të punës së KKS-së për vitin 2025,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit financiar për vitin fiskal 2025,
8. Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e tretë, korrik-shtator 2025,
9. Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katërt, tetor-dhjetor 2025,
10. Shqyrtimi i Raportit të Planit të Integritetit për vitin 2025,
11. Shqyrtimi i Raportit të zbatimit të Planit të Veprimit për Transparencë për vitin 2025,
12. Raporti Vjetor i Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve- Istog 2024-2026,
13. Shqyrtimi i Raportit të Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024-2026,
14. Raporti i punës së KRM Ambienti Njësia Operative Istog (janar- dhjetor) 2025,
15. Realizimi i planit Objektivat e menaxhimit të mbeturinave dhe plani operacional 2025,
16. Raporti i Planit të Veprimit për Energji të Qëndrueshme dhe Klimë,
17. Raporti vjetor i mekanizimit komunal kundër Dhunës në Familje për vitin 2025,
18. Njoftimi me Raportin Vjetor për kontratat e nënshkruara publike për vitin 2025,
19. Njoftimi me Raportin e Performances për vitin 2024.
20. Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së përgjithshme dhe të Veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026,
21. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft- Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026,

22. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për Autorizimin e Kryetarit të Komunës për nënshkrimin e marrëveshjes për bashkëpunim ndër komunal për qëllim të formimit, organizimit dhe monitorimit të qendrës për zhvillim rajonal me rajonin zhvillimor perëndimor.

Pyet ekzekutivin dhe Kuvendin a kanë diçka të shtojnë lidhur me rendin e ditës. Fjalën e ka Astrit Hajrizaj.

**Astrit Hajrizaj, PDK-** Duke u bazuar në ligjin për Vetëqeverisje Lokale neni 47 pika 2 ku neve si anëtarë të Kuvendit na mundëson që ti bëjmë propozimet tona, dhe ne propozojmë që pika e 20 e rendit të ditës të largohet nga rendi i ditës, parimisht ne jemi pro, por i kemi vërejtjet tona sa i përket materialit na kanë ardhur pjesë pjesë. Duke parë që është çështje e rëndësishme dhe kërkon një diskutim pak më të gjërë, kjo çështje propozoj se duhet të shtyhet për mbledhjen e ardhshme dhe të diskutojmë më gjërë.

**Kryetari i Komunës-** në rend dite thotë 'Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së përgjithshme dhe të Veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026, pra që planifikohen e jo që jepen në shfrytëzim. Planifikim që e bën ekzekutivi në bazë mundësisë që ja jep ligji me pranuar kërkesat e investitorëve, fermerëve e natyrave të tjera të dhënies në shfrytëzim të pronave komunale. Është afat ligjor 31 Marsi që me e kaluar këtë listë dhe me e pasur mundësinë që ato prona që janë të pashfrytëzuara me u kthyer në potencial në zhvillimit social e ekonomik të komunës. Ligjërisht nëse kjo pikë shtyhet sot për këtë vit Astriti saktë e di që neve na pamundësohet me i krijuar zhvillim të ri komunës tonë. Kërkesa që me e shtyer si pikë në qoftë se kishim qenë në janar apo shkurt kishte me qenë legjitime edhe juridikisht edhe politikisht, por me e kaluar Marsin i bie që ja pamundëson dhënien në shfrytëzim të pronave.

**Astrit Hajrizaj, PDK-** sa i përket interesit publik dhe zhvillimit ekonomik për dhënien në shfrytëzim të këtyre pronave e di shumë mirë sa presionin e kam bërë kur kam qenë pjesë e ekzekutivit që këto prona me u dhënë në shfrytëzim. Kryetari tha nuk na mundëson ligji me u shtyer për mbledhjen e ardhshme gjë që është e pavërtetë do ta demantoj menjëherë në pjesën e ligjit. Duke u bazuar në ligjin për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të pronës komunale Ligji 06/L-092 neni 13 e specifikon shumë qartë, komuna duhet të publikon listën e përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës dhe listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin vijues deri me datën 31 dhjetor të vitit aktual për vitin vijues. Nëse afati i fundit ka qenë 31 marsi pse nuk e keni sjellë më herët por e keni lënë në ditën e fundit ku dihet se zgjedhjet kanë përfunduar me 12 tetor.

**Kryetari i Komunës-** Astrit, në rastet kur është vit zgjedhor që e kemi lënë pas ne shtyhet për tre muaj procesi i publikimit të listës së veçantë dhe të përgjithshme të dhënies në shfrytëzim të pronave. E drejta që me e sjellë ne sot në propozim është plotësisht juridikisht dhe politikisht legjitime. Kërkesa e jote për me e shty, për me e pas të qartë qytetarët e komunës së Istogut është për me ja u pamundësuar ose me na pamundësuar neve që atyre qytetarëve me ja u dhënë këto prona në shfrytëzim.

**Astrit Hajrizaj, PDK-** kjo që kryetari po mundohet me e kthyer politikisht që po ja pamundësojmë qytetarëve që me i marrë këto prona është e pavërtetë. Nuk mundem me qenë kundër ku unë jam ai që kam bërë presion që këto sipërfaqe me u dhënë në shfrytëzim. Po kërkoj me u shty për mbledhjen tjetër. Nuk e ke në ligj të precizuar 31 marsin.

**Kryetari i Komunës-** është vendim i MAPL-së që në rastet kur ka vit zgjedhor thotë shtyhet për tre muaj.

**Niman Beqiraj, LVV-** i pata dy tema me i diskutuar, fillimisht me u ndërlidhur me këtë temën që ishte më herët se është mbledhja e katërt dhe po pajtohem me kolegun që ka pasur kohë që me ardhë kjo edhe më herët. Ndërsa pika tjetër që po dua a propozoj ka të bëj me 'pyetje dhe përgjigje' ose si e kem pasur mandatin e kaluar 'të ndryshme'. Në mbledhjen që e kemi pasur të grupit punues për hartimin e Planit të Punës ke qenë dëshmitar kryesues dhe ke premtuar që ajo ka me hy si pikë e në të kundërtën në KPF në rekomandime me votë të dyfishtë e ke përdor kundër asaj çfarë e ke premtuar në at grup punues. Heqja e kësaj pike ka qenë më shumë me e kufizuar fjalën dhe me e zbeh rolin e opozitës. Nuk jemi këtu me votuar vetëm mekanikisht por për me pyet, me e sfiduar pushtetin. Ka qenë gabim që e keni hequr, dhe po kërkojmë me e kthyer prapë.

**Kryetari i Komunës-** po e ngatërroni rolin e anëtarit të Kuvendit me të deputetit. Ti nuk e mbikëqyr ekzekutivin sepse nuk e zgjedh ekzekutivin dhe nuk ke asnjë drejtë ligjore për atë.

**Niman Beqiraj, LVV-** kë kem të drejtë pra me e mbikëqyrë nëse jo juve? Pse nuk po e bën rendin e ditës vet, po po i sjellë në Kuvend. Si e ke marrë votën ti e kemi marrë edhe ne. Unë e kam marrë votën për në Kuvend, me e sjellë një kërkesë apo me ta parashtruar një pyetje, pastaj ajo mbetet përgjegjësi e jotja. Unë kam drejtë me e sjellë deri këtu edhe ndërro qasjen se je kryetar i Komunës.

**Kryetari i Komunës-** Niman po ta ritheksoj nuk e mbikëqyrë ekzekutivin e komunës. Kuptojeni ligjërisht. E jo me tentuar me e kuptuar se qasja ime po don me ja u pamundësuar juve, jo sepse kam qëndruar mandatin e kaluar nga 6 orë këtu për secilën pyetje që e keni pasur, qoftë edhe ato që nuk kanë pasur kuptim fare e ato me marrë ndonjë votë, e kuptoj se politikë po bëjmë.

**Kryesuesi i Kuvendit-** jep sqarim. Fjalën e ka Niman Beqiraj.

**Niman Beqiraj, LVV-** kryesues ti ke thënë se nuk ka nevojë kjo me hy si pikë e rendit të ditës për shkak se është e nënkuptueshme, dhe është e njëjtë si pika e parë dhe e dytë e çdo rendi të ditës lidhje me arsyetimin e mungesave në mbledhje dhe procesverbalit. Këto kanë qenë fjalët tua. Pika 'pyetje dhe përgjigje' ose si e kem pasur mandatin e kaluar 'të ndryshme'. E kjo 'të ndryshme' është në çdo komunë. Nëse çdo komunë po e shkelka ligjin e ti spo e shkelshe po më çuditë, se pak më herët deshe me e shkel për betimin e anëtarëve e tash jo.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Arben Kabashi.

**Arben Kabashi, PDK-** po pajtohem me atë që e lexove për Rregulloren e Kuvendit, por ndoshta ke harruar ta cekesh që anëtari i Kuvendit, duke e ditur se komplet Kuvendi është organi më i lartë vendimmarrës, përderisa ty ta jep të drejtën me propozuar me diskutuar pika të reja të rendit të ditës brenda mbledhjes së Kuvendit. Sa i përket temës tjetër Astriti vetëm kërkoj që ajo pikë do diskutim, pastaj nuk është faji as i opozitës as i pozitës që anëtarët e rinj nuk e kanë dhënë betimin, e as nuk është faji jonë që kemi ardhur ditën e fundit të dhënies në shfrytëzim të pronave. Shkaktar kryesor është kryetari i komunës.

**Kryetari i Komunës-** po kthehem prapë te arsyetimi pse kërkohej që pika 20 të shtyhet. Asnjë arsyetim nuk ishte. Çështja e afatit 5 mujor pse kemi ardhur në këtu është sepse mua ma mundëson të drejtën ligji për me sjellë në këtë ditë sot sepse kemi qenë në vit zgjedhor. Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit është çështje formalo-politike, e po tentoni ta ktheni në diçka tjetër, kemi vite para nesh, e pika tjera që mundeni me u kap, por jo te kjo.

**Arben Kabashi, PDK-** unë thashë Kuvendi është organi vendimmarrës më i larti në nivel lokal. Ndaj këto gjëra, ekzekutivi e dimë çfarë është por edhe legjislativi.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Astrit Hajrizaj.

**Astrit Hajrizaj, PDK-** këtu fjalën na kanë dhënë qytetarët. Unë po propozoj që pika të shtyhet për scancën tjetër, dhe duhet të hedhet në votim se të obligon ligji dhe kaq ka diskutim në lidhje me këtë temë.

**Kryetari i Komunës-** Astrit a ka mundësi me na sqaruar neve dhe qytetarëve të Komunës së Istogut që po na dëgjojnë cilat janë gabimet në atë listë, cilat janë propozimet e këqija në atë listë, cilat janë parcelat që nuk duhet me qenë, soe cilat i kemi harruar ne me i bë pjesë të asaj liste, që unë dhe qytetarët me e kuptuar pse ju po e shihni si interes publik shtyrjen për një kohë tjetër të aprovimit të kësaj liste.

**Astrit Hajrizaj, PDK-** qëllimi dhe arsyet janë pikërisht këto: kur flasim për parcelizimin, aludojmë se duhet të bëhen për disa parcela. Në këtë seancë kemi pasur një material bukur voluminoz dhe është dashur të diskutohen. Materiali ka ardhur në tri pjesë, çështjen e parcelizimit e kërkojmë për shkak të transparencës sepse parcelat e mëdha mos ta marrin vetëm nga një person por të krijohet mundësia edhe për persona tjerë. E ke mundësinë kryesues me e hedh në votim. Votohet apo jo është diçka tjetër.

**Kryetari i Komunës-** prapë nuk u përgjigje Astrit. Materiali nuk është vonuar por kopjet e planit. Ka plot parcela që po supozojmë i ka 50 hektarë por është bërë kërkesa që me i marrë 10 ari të atyre 50 hektarëve, dhe ato 10 ari ne ja japim në shfrytëzim jo 50 hektarë. Për secilën e keni ditur, keni qenë pjesë edhe të komisioneve. E dyta nuk e dhe asnjë propozim se cila parcelë është gabim apo se cila parcelë ju vlerësoni që duhet me mbetur në menaxhim të komunës e jo me dhënë në shfrytëzim, ose cilat parcela duhet me i shtuar që i kemi harruar. I bie që nuk ka analizë thelbësore të materialit. Po kërkon ta shtyni pa arsye thelbësore. Shumë e vërtetë është që ke të drejtë me propozuar me shty pikë të rendit të ditës dhe nuk ka kush që ta mohon, por edhe unë kam të drejtë me e sjellë në afatin që ma ka përcaktuar ligji me të cilin ne funksionojmë. Nëse sot nuk kalon kjo listë këto prona më nuk mund të jepen në shfrytëzim brenda këtij viti dhe të gjithë e dini këtë fort mirë.

**Lulzim Shoshi-**përsëritet të gjithë të pranishmit! Pika për të cilën po bëhet ky diskutim e ky ngërç së pari duhet me e pas primare arsyen qytetare dhe të bujqëve sepse këto parcela mbi 400 hektarë pjesa dërrmuese janë toka bujqësore. A duhet të jetë pika e parë apo e dytë dhënia e betimit po më duket që opozita ku jam edhe vet opozitë duke parë që nuk ka vota të mjaftueshme pa betimin e anëtarëve të rinj, nuk e di sa është e ndershme, Astrit, Arben dhe Niman, kemi kohë sa të doni me ba politikë në të ardhmen, unë jam për me e kaluar këtë pikë të rendit të ditës dhe me ju mundësuar fermerëve që me i marrë dhe me i shfrytëzuar ato prona.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Kaltrina Arifaj.

**Kaltrina Arifaj, PDK-** përsëritet të gjithë të pranishmit! Po i drejtohem kryetarit, përpos përgjigjes që na e dha kur të dua e sjellë në Kuvend, cilën do pikë të rendit të ditës, e në këtë rast pikën që po e diskutojmë, pse kryetar e prite ditën e fundit me e sjellë në Kuvend këtë pikë kaq të rëndësishme për qytetarët e Istogut?

**Kryesuesi i Kuvendit-** i hedhim në votim dy propozimet e dhëna, këtu nuk kanë drejtë vote anëtarët që kanë me dhënë betimin.

Propozimi i parë është i Astrit Hajrizaj për me e heq nga rendi i ditës pikën e 20 të rendit të ditës 'Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së përgjithshme dhe të Veçantë

të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026? Kush është për?

**Kostatojmë se prezent janë 20 anëtarë të Kuvendit që kanë të drejtë vote**

**Konstatojmë që nga 20 anëtarë të pranishëm me 8 vota për 11 kundër 1 abstenim nuk kalon propozimi i anëtarit të Kuvendit Astrit Hajrizaj që të hiqet (shtyhet) kjo pikë e rendit të ditës.**

Propozimi i dytë është nga anëtari i Kuvendit Niman Beqiraj, që të hyn në rend dite pika 'të ndryshme' ose 'pyetje dhe përgjigje'? kush është që kjo pikë të hyn në rend dite?

**Konstatojmë që nga 20 anëtarë të pranishëm me 14 vota për 3 kundër 3 abstenime kalon propozimi i anëtarit të Kuvendit Niman Beqiraj.**

Vazhdojmë me mbledhjen :

Opozita lëshojnë mbledhjen

PDK , LVV dhe AAK, largohen nga mbledhja (ora 11:27)

**Kryesuesi i Kuvendit** – pasi që kuorum nuk kemi mbledhja do të vazhdojë për kohën do të njoftoheni.

Vazhdimi i mbledhjes së katërt të rregullt të Legjislacionit të VIII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 30.03.2026, në Saliën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 14:30.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- |                                |                          |
|--------------------------------|--------------------------|
| 1. Enver Rugova, LDK;          | 10. Hajrush Shoshi, LDK; |
| 2. Zenel Shatri, LDK;          | 11. Haki Podrimaj, LDK;  |
| 3. Arianit Selmanaj, LDK;      | 12. Valbona Demaj, LDK;  |
| 4. Faruk Kabashi, LDK;         | 13. Faik Alushaj, LDK;   |
| 5. Ruzhdi Metaj, LDK;          | 14. Bedri Haxhiu, LDK;   |
| 6. Arta Balaj, LDK;            | 15. Fjolla Ukaj, AAK;    |
| 7. Liridona Lajqi Avdiaj, LDK; | 16. Lulzim Shoshi, L.SH; |
| 8. Ajshe Imeraj, LDK;          | 17. Valmir Rama, IRDK;   |
| 9. Abetare Sutaj Arifaj, LDK;  |                          |

**Kryesuesi i Kuvendit-** Përshëndetje po vazhdojmë seancën e paradites.

**Konstatohet që i kemi 16 anëtarë të Kuvendit të pranishëm në mbledhje.**

Në bazë të ligjit gjithçka është në rregull, dmth nuk e kemi mbyllë seancën. Kemi bërë konsulta edhe në me organet përgjegjëse në MAPL, kështu që po vazhdojmë me mbledhjen e paradites. Paraprakisht, për rend dite duhet të heqim, një pikë të rendit të ditës, që ka të bëjë mbledhjen urgjente që ishte pak më parë dhënia e betimit, kështu që vazhdojmë tutje. A ka pyetje apo ndonjë vërejtje ekzekutivi apo dikush nga anëtarët e Kuvendit. Fjalën e ka Zenel Shatri.

**Zenel Shatri, LDK-** a duhet të shqyrtohet pika e parë tani prapë , vetëm nga ana ligjore po pyes.

**Kryesuesi i Kuvendit-** është vazhdim. E cekta në fillim të mbledhjes se sa jemi të pranishëm.

Hedh në votim pikën e dytë të rendit të ditës që ta heqim nga rendi i ditës? Pra pikën 'dhënia e betimit'.

**Konstatohet që me 16 anëtarë të pranishëm me 15 vota për 0 kundër 1 abstencione miratohet propozimi i kryesuesit që të hiqet kjo pikë nga rendi i ditës.**

Pika tjetër pyetje dhe përgjigje, unë propozoj që të hiqet pasi që është votuar, por unë propozoj që të rivotohet dhe për shkak të keqkuptimeve që janë bërë këtu, pika që është propozuar nga një anëtar që më nuk është prezent në mbledhje propozoj të hiqet nga rendi i ditës për mbledhjen e sotme.

**Kryetari i Komunës-** me sa di unë kërkesa për atë pikë është pak jashtë Rregullores. Secila mbledhje e Kuvendit, thirret me një rend dite, njëjtë si anëtarët e Kuvendit për tu përgatitur për atë rend dite e kanë edhe pjesa e ekzekutivit. Disavantazhi që krijohet nuk është vetëm politik, është mungesë e përgatitjes për shkak që ekzekutivi nuk e ka idenë se cilat kanë me qenë pyetjet që kanë me ardhur prej legjislativit. Propozimi im është që me e përkthyer në një formë tjetër. Në momentin që secili prej anëtarëve të Kuvendit eventualisht grup i anëtarëve të Kuvendit, i paraqitet një temë që konsiderohet e rëndësishme publike me e fut si pikë jashtë rendit të ditës. Dhe i garantoj edhe anëtarët e Kuvendit që nuk janë pjesë e LDK-së që kanë me i pas votat e LDK-së sa herë që ka nevojë kur bëhet fjalë për interes të publikut e të qytetarëve apo interes i juaji si anëtarë të Kuvendit me i ngritur si çështje. Mendoj që është me korrekte për të gjithë ne. E kuptoj edhe të bërit opozitë edhe të bërit pozitë por konsideroj që duhet të jemi korrekt me njëri tjetrin.

**Kryesuesi i Kuvendit-** e hedh në votim propozimin tim që të hiqet nga rendi i ditës ajo pikë që u votua me herët.

**Konstatohet që me 16 anëtarë të pranishëm me 14 vota për 2 kundër 0 abstenime miratohet propozimi i kryesuesit që të hiqet kjo pikë nga rendi i ditës.**

E hedh në votim rendin e ditës në tërësi.

**Konstatohet që me 16 anëtarë të pranishëm me 16 vota për 0 kundër 0 abstenime miratohet rendi i ditës për mbledhjen e sotme.**

### **R e n d i t e**

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Dhënia e Betimit të anëtarëve të Kuvendit të komunës,
3. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
4. Shqyrtimi i raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2025,
5. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2025,
6. Shqyrtimi i Raportit të punës së KKSB-së për vitin 2025,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit financiar për vitin fiskal 2025,
8. Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e tretë, korrik-shtator 2025,
9. Shqyrtimi i Raportit financiar për tremujorin e katërt, tetor-dhjetor 2025,
10. Shqyrtimi i Raportit të Planit të Integritetit për vitin 2025,
11. Shqyrtimi i Raportit të zbatimit të Planit të Veprimit për Transparencë për vitin 2025,
12. Raporti Vjetor i Ekipit për të Drejtat e Fëmijëve- Istog 2024-2026,
13. Shqyrtimi i Raportit të Planit Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024-2026,
14. Raporti i punës së KRM Ambienti Njësia Operative Istog (janar- dhjetor) 2025,
15. Realizimi i planit Objektivat e menaxhimit të mbeturinave dhe plani operacional 2025,
16. Raporti i Planit të Veprimit për Energji të Qëndrueshme dhe Klimë,
17. Raporti vjetor i mekanizimit komunal kundër Dhunës në Familje për vitin 2025,
18. Njoftimi me Raportin Vjetor për kontratat e nënshkruara publike për vitin 2025,
19. Njoftimi me Raportin e Performances për vitin 2024.
20. Shqyrtimi dhe miratimi i Listës së përgjithshme dhe të Veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026,
21. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft- Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026,
22. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim Vendimit për Autorizimin e Kryetarit të Komunës për nënshkrimin e marrëveshjes për bashkëpunim ndër komunal për qëllim të formimit, organizimit dhe monitorimit të qendrës për zhvillim rajonal me rajonin zhvillimor perëndimor.

### **Shqyrtimi i pikës 3.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** procesverbalin e mbledhjes së kaluar e keni marrë materialin, a ka ndonjë vërejtje apo sugjerime? Pasi që jo e hedh në votim? Kush është për?

**Konstatohet** që me 16 anëtarë të pranishëm me 16 vota për 0 kundër 0 abstenime miratohet procesverbalet e mbledhjes së kaluar.

### **Shqyrtimi i pikës 4.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** e keni marrë Raportin e Punës së Kuvendit të komunës për vitin 2025 . A ka dikush diçka? Pasi që jo vazhdojmë me pikën tjetër.

### **Shqyrtimi i pikës 5.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Kryetari i Komunës.

**Kryetari i Komunës-** materialin e keni marrë, pasi që ka pika shumë në rend dite, nuk isha ndalur në prezantim, që ka dikush pyetje jemi të hapur. Faleminderit!

**Kryesuesi i Kuvendit-** faleminderit Kryetar! Hapi debatin. Pasi që nuk ka dikush diçka, vazhdojmë tutje.

### **Shqyrtimi i pikës 6.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Kryetari i Komunës.

**Kryetari i Komunës-** materialin e keni marrë, që ka dikush pyetje jemi të hapur. Faleminderit!

**Kryesuesi i Kuvendit-** faleminderit Kryetar! Hapi debatin. Pasi që nuk ka dikush diçka, vazhdojmë tutje.

### **Shqyrtimi i pikës 7.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Kryetari i Komunës.

**Kryetari i Komunës-** materialin është pranuar me kohë, që ka dikush pyetje në lidhje me këtë raport jemi të hapur. Faleminderit!

**Kryesuesi i Kuvendit-** faleminderit Kryetar! Hapi debatin. Pasi që nuk ka dikush diçka. Për këtë raport duhet të votojmë, kush është për?

**Konstatojmë që me 16 anëtarë të pranishëm me 16 vota për 0 kundër 0 abstenime miratohet Raporti Financiar për vitin fiskal 2025.**

**Shqyrtimi i pikës 8.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** nuk kemi mbajtur mbledhje 6 muaj, janë raporte që duhet të dalin në Kuvend, a e dëshiron dikush fjalën? Pasi që jo vazhdojmë tutje.

**Shqyrtimi i pikës 9.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** prapë e njëjta, e hapi debatin, a e dëshiron dikush fjalën? Pasi që jo vazhdojmë tutje.

**Shqyrtimi i pikës 10.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Kryetari i Komunës.

**Kryetari i Komunës-** materialin është pranuar me kohë, që ka dikush pyetje, paqartësi apo diçka në lidhje me këtë raport jemi të hapur. Faleminderit!

**Kryesuesi i Kuvendit-** faleminderit Kryetar! Hapi debatin. Pasi që nuk ka dikush diçka.

**Shqyrtimi i pikës 11.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Kryetari i Komunës.

**Kryetari i Komunës-** materialin është pranuar me kohë, që ka dikush pyetje, paqartësi apo diçka në lidhje me këtë raport jemi të hapur. Faleminderit!

**Kryesuesi i Kuvendit-** faleminderit Kryetar! Hapi debatin. Pasi që nuk ka dikush diçka. Vazhdojmë tutje.

**Shqyrtimi i pikës 12.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Kryetari i Komunës.

**Kryetari i Komunës-** materialin është pranuar me kohë, që ka dikush pyetje, paqartësi apo diçka në lidhje me këtë raport jemi të hapur. Është edhe zyrtarja përgjegjëse këtu. Faleminderit!

**Kryesuesi i Kuvendit-** faleminderit Kryetar! Hapi debatin. A e dëshiron fjalën dikush? Pasi që nuk ka dikush diçka. Vazhdojmë tutje.

**Shqyrtimi i pikës 13.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Kryetari i Komunës.

**Kryetari i Komunës-** materialin është pranuar me kohë, që ka dikush pyetje, paqartësi apo diçka në lidhje me këtë raport jemi të hapur. Faleminderit!

**Kryesuesi i Kuvendit-** faleminderit Kryetar! Hapi debatin. Pasi që nuk ka dikush diçka.

**Shqyrtimi i pikës 14.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Kryetari i Komunës.

**Kryetari i Komunës-** materialin është pranuar me kohë, që ka dikush pyetje, paqartësi apo diçka në lidhje me këtë raport jemi të hapur. Faleminderit!

**Kryesuesi i Kuvendit-** faleminderit Kryetar! E hapi debatin, Lulzim Shoshi e ka fjalën.

**Lulzim Shoshi-** përshëndet të gjithë të pranishmit! E kam lexuar raportin edhe pse ishte shumë i gjatë, raport më të mirë unë nuk kam parë. Është mandati i katërt që jam këtu dhe unë dua të përgëzoj për punën që po e bën, e kam parë realizimin e të hyrave 96% vazhdoni kështu jeni shembull në komunën tonë. Edhe ju drejtorët e ri merrni shembull, punoni mirë. Faleminderit!

**Kryesuesi i Kuvendit-** unë kam një pyetje për drejtorin për deponitë ilegale, p.sh. a ka ndonjë mundësi që kompanitë kur rregullojnë rrugë me u marrë vesh me ta se te rruga në Uçë që të dërgon në Zubin Potok një deponi atje me intervenuar me kanë porositur Komiteti për Komunitete me e transmetuar këtë te ju.

**Alferd Tahirsylaj-** përshëndet të gjithë të pranishmit! Faleminderit për pyetjen por deponitë ilegale janë kompetencë e drejtorisë së Shërbimeve Publike.

**Kryesuesi i Kuvendit-** a e dëshiron edhe dikush fjalën. Pasi që jo vazhdojmë tutje.

**Shqyrtimi i pikës 15.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** materialin e keni marrë me kohë. Komuna e Istogut është shembull në menaxhimin e mbeturinave. E hapi debatin, a ka dikush diçka? Pasi që jo vazhdojmë tutje.

#### **Shqyrtimi i pikës 16.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** materialin e keni marrë me kohë. Është një domen që është duke u investuar shumë në këtë Plan të Veprimit. E hapi debatin rreth kësaj pike. Pasi që nuk ka diçka vazhdojmë tutje.

#### **Shqyrtimi i pikës 17.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** një pikë mjaft e ndjeshme, fatkeqësisht shumë aktuale në Kosovë. Duhet të kontribuohet me shumë në këtë drejtim. E hapi debatin, a e dëshiron dikush fjalën? Pasi që jo vazhdojmë tutje.

#### **Shqyrtimi i pikës 18.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** sa i përket kësaj pike, e kemi përgjegjësin e Prokurimit këtu prezent materialin e keni marrë me kohë. E hapi debatin, a e dëshiron dikush fjalën? Pasi që jo vazhdojmë tutje.

#### **Shqyrtimi i pikës 19.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** E kemi këtu përgjegjësin që merret me performancë vazhdimisht. Është koordinator i grupit për performancë. A ka pyetje ose sugjerime rreth materialit që keni pranuar? Pasi që jo vazhdojmë tutje.

#### **Shqyrtimi i pikës 20.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** ftoj drejtorin Agon Dreshaj.

**Agon Dreshaj-** përshëndet të gjithë të pranishmit dhe prezanton pikën e rendit të ditës?

**Kryesuesi i Kuvendit-** faleminderit drejtor! Fjalën e ka Kryetari i Komunës.

**Kryetari i Komunës-** një qartësim shtesë, se nganjëherë ngritet si pikëpyetje në kokën e secilit kur shihet numri i madh i hektarëve që në planifikojmë që me i pas pjesë të proceseve të dhënies në shfrytëzim të pronave afatgjatë. Nuk nënkupton aprovimi i listës me dhënien në shfrytëzim të pronave. Nënkupton hapin e parë që neve na i hap dyert me diskutuar me investitorët, eventualisht fermerët potencial që me i iniciuar procedurat për dhënien në shfrytëzim. Përndryshe nëse kjo listë nuk kalon, ne nuk kemi të drejtë as me i filluar negociimet as me i orientuar ata drejtë paraqitjes kërkesave për marrjen në

shfrytëzim të këtyre pronave. Ta keni parasysh që përpos votës së propozim-vendimit paraprakisht jeni të kyçur si asambleistë sipas fuqisë politike nëpër komisionet që bëjnë vlerësimin e ankandeve ku ne i shpallim këto prona për me i dhënë në shfrytëzim, përveç nëse ka ndonjë interes të madh publik mua ma jep të drejtën për negociim direkt që për këtë mandat ka ndodhur vetëm me dy-tri prona, pjesa tjetër ka qenë përmes ankandit publik.

**Kryesuesi i Kuvendit-** e hapi debatin. Fjalën e ka Lulzim Shoshi.

**Lulzim Shoshi-** sa është afati, sa e keni paraparë drejtor, kush e udhëheq këtë komision? Edhe në një rast kur është dhënë një parcelë e madhe e ka marrë dikush që jeton në botën e jashtme dhe ai po e stërshitke te fermerët, kërkoj nga kryetari direkt që të jetë shumë i kujdesshëm dhe vigjilent që pronat bujqësore sidomos ata që i marrin për shfrytëzim t'i marrin 100% fermerët dhe të specifikohet në kontratë që nëse nuk e punon me e pas të drejtën me ja marrë pastaj prapë.

**Kryesuesi i Kuvendit-** Kryetari i komunës e ka fjalën.

**Kryetari i Komunës-** ligji na mundëson prej 2 deri në 99 vite, mirëpo e shumta që mandatin e kaluar e kemi dhënë në shfrytëzim ka qenë 40 vite. Dhe prapë nuk e kemi në plan ta tejkalojmë këtë afat. Po supozojmë te rastet e solareve e kemi dhënë prej 25 deri në 30 vite për shkak se aq ka produktivitet paneli solar. Te fermerët kemi dhënë prej 5 deri në 15 vite nëse nuk jam gabim varësisht prej natyrës.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Faruk Kabashi.

**Faruk Kabashi LDK-** këto prona që i keni sjellë për me i qit në ankand, unë jam për, por kishte qenë mirë me i shikuar sepse janë disa prona që disa qytetarë i konsiderojnë si të tyre që i kanë marrë para disa vitesh.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka drejtori Agon Dreshaj.

**Agon Dreshaj-** normalisht është shqyrtuar historiat i secilës parcelë që e qesim në listën e veçantë të pronave. Rastet që po i përmend ti janë sfidë në kreu të Kosovës, por ka shumë prej tyre që rastet i kanë humbur në gjykatë.

**Kryesuesi i Kuvendit-** faleminderit drejtor! Fjalën e ka Kryetari i Komunës.

**Kryetari i Komunës-** i mbeta borxh Lulzimit në përgjigje. Në kontratë ceket decidivisht sepse është e paraparë me ligj që toka që merret në shfrytëzim është ekskluzivisht e dedikuar për personin juridik apo fizik që e merr në shfrytëzim. Ai as nuk ka të drejtë shitje as stërshitje, momentin që e bën një gjë të tillë është vepër penale dhe shkon para organeve të drejtësisë. Ne nuk kemi rast që të

paktën e kemi evidentuar, nëse dikush ka, ju kisha lutur që edhe në formë anonime me na njoftuar dhe sigurisht që kemi me i marrë masat tona konform kontratës që e ka të nënshkruar ai person apo eventualisht ajo kompani.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Valmir Rama.

**Valmir Rama IRDK-** përshëndet të gjithë të pranishmit! Unë jam për me i dhënë në shfrytëzim pronat komunale, por vlen të theksohet se një numër i konsiderueshëm i komunitetit të cilit i takoj, komunitetit egjiptian merret me veprimtarinë e bujqësisë dhe mendoj që në këtë rend të parashihen disa masa afirmative të cilat do t'i përkrahin dhe do ti favorizojnë komunitetet me marrjen e pronave në shfrytëzim për punimin e tokave të bujqësisë.

**Kryesuesi i Kuvendit-** për çështje afirmative ky është ankand edhe duhet të shkoj në bazë të ligjit.

**Kryetari i Komunës-** nëse Valmiri e gjen bazën ligjore përmes së cilës ne mundemi me i siguruar përparësi normalisht që edhe ne kemi me qenë në funksion të përkrahjes së kategorive të marginalizuara po e quaj kështu.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Hajrush Shoshi.

**Hajrush Shoshi ,LDK-** përshëndet të gjithë të pranishmit! Njëherë kam një pyetje , kam parë që shumë prona janë prona pyjore, që janë llogaritur të jepen këto prona me qira, ka disa prona që janë pyje pak më të dendura, kështu që ish dashur që paraprakisht të ndërrohet kultura nga komuna dhe pastaj të qiten ato prona për dhënie në shfrytëzim. E kam edhe një kërkesë që prona 1014/4 që është në Dobrushë, kërkoj që ajo pronë mos të jepet në shfrytëzim, të hiqet nga lista sepse duhet të mbetet si e mirë e fshatit, ne kemi pasur edhe njëherë kërkesë që ajo pronë të bëhet për varreza të fshatit, mirëpo mund të ndërtohet ndonjë fushë e futbollit apo diçka tjetër, ajo është komplet para shkolle. Ajo nuk ka shanse me u bërë tokë bujqësore.

**Kryesuesi i Kuvendit-** Fjalën e ka Lulzim Shoshi.

**Lulzim Shoshi-** desha t'i ndihmoj Hajrushit pak. Për pronën në fjalë po dua ta përkrah Hajrushin por përgjysmë. Po flasim për një parcelë te shkolla e fshatit Kashicë dhe fillon nga një shkollë te një shkollë tjetër. Propozoj nga kjo parcelë të hiqet një pjesë, ajo pjesa që i takon shkollës dhe mos të jetë në mesin e këtyre pronave tjera që po jepen në shfrytëzim, dhe ajo të jetë në të ardhmen të jetë për diçka që ka nevojë fshati.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Kryetari i Komunës.

**Kryetari i Komunës-** ne nuk e kemi ndërmend me e dhënë gjithë parcelën në shfrytëzim bashkë me shkollën. Normalisht interesi publik e sidomos i fshatit është prioritet para prioriteteve. Nuk ka hyrë ajo pa qenë kërkesë e disa banorëve që jetojnë aty, unë e di që është shkolla, por e di edhe sa vite ka funksionuar shkolla. Ka mbetur një objekt që është degraduar dhe për ne është kthyer veç në një aset të amortizuar kurdoherë duhet të ri investohet në të që me riaktivizuar, kemi biseduar me shumë aty që me u bë si shtëpi e fshatit por nuk ka pasur interesim aq të madh për atë lloj bashkëpunimi që ne e kemi ofruar, por kjo nuk nënkupton që nuk ma me pasur mundësi tutje edhe në të ardhmen. Ka parcelë që i ka ndoshta 300 hektarë por për me ja marrë 50 ari në shfrytëzim duhet me fut gjithë parcelën si pronë për dhënie në shfrytëzim. Te pjesa e tokës pyjore Hajrush, është e vërtetë por të njëjtën klasë të tokës e ka pasur edhe parcela e tokës që është dhënë në Shalë të Bajgorës që sot është kthyer në një prej prodhueseve më të mëdhenj të energjisë së ripërtëritshme në Kosovë.

**Kryesuesi i Kuvendit-** replikë Hajrush Shoshi.

**Hajrush Shoshi, LDK-** parcela e shkollës është e ndarë parcelë në vete. Janë edhe disa parcela tjera që kanë me u dhënë në shfrytëzim, por kjo ekskluziv është pjesë e shkollës. Është vetëm një hektar. Për këtë parcelë kërkoj që të hiqet prej dhënies në shfrytëzim. Jep sqarim shtesë.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka drejtori, Agon Dreshaj.

**Agon Dreshaj-** jep sqarim shtesë lidhur me këtë pikë. Dhe shton dy propozime shtesë në listë, parcela 3-0 zona kadastrale Sinajë me u bë pjesë e kësaj liste parcela në total ka 664 hektarë ku normalisht jepet në shfrytëzim vetëm ajo pjesë për të cilën koordinohet edhe komuna edhe ministria. Po ashtu një kërkesë që ka ardhur më vonë është kërkesa nga kompania "Hidrodrini" për marrjen në shfrytëzim të lokalit me qira në Istog të lokalet me numër 39-4-1-0 me qenë me konkret të lokali ku ka qenë e vendosur Banka Ekonomike. E kemi regjistruar si njësi i ka 142 m<sup>2</sup> bruto. Kërkoj që të bëhet edhe kjo pjesë e kësaj liste. Kanë kërkuar që së paku 5 vite ta marrin në shfrytëzim atë lokal.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Kryetari i Komunës.

**Kryetari i Komunës-** një qartësim të shkurtër, ne pjesë të listës nuk mundemi me e bërë duke i dhënë ekskluzivitet kompanisë "Hidrodrini" ne e bëjmë pjesë të listës e tutje e shohim procedurën përmes ankandit apo negocimit duke konsideruar që është kompani publike dhe pjesë e interesit publik tonë.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Liridona Lajçi.

**Liridona Lajçi, LDK-** përshëndet të gjithë të pranishmit! Këto dy kërkesa që i ceku drejtori që janë bërë me vonesë dhe me hy në rend dite sot, kur ka qenë afati i fundit i këtyre kërkesave, dhe a ka ndonjë arsye me e shtjelluar më shumë se pse?

**Agon Dreshaj-** e dini të gjithë datën e emërimit që e kemi pasur, dhe pasi e kemi përgatitur këtë material kanë ardhur këto dy kërkesa. Parcela në Sinajë është e interesit nacional, ndërsa te pjesa e lokalit e shtjellova kërkesën edhe nga kush ka ardhur.

**Kryesuesi i Kuvendit-**a e dëshiron dikush fjalën? Jo atëherë hedh në votim, propozimin e parë nga ekzekutivi për pronën në Sinajë? Kush është për?

**Konstatojmë që nga 17 anëtarë të pranishëm me 17 vota për 0 kundër 0 abstenime miratohet propozimi i ekzekutivit që kjo pronë të futet në këtë listë.**

Hedh në votim propozimin e dytë, lokalit të ish Banka Ekonomike, kush është të futet në këtë listë.

**Konstatojmë që nga 17 anëtarë të pranishëm me 17 vota për 0 kundër 0 abstenime miratohet propozimi i ekzekutivit që ky lokal të futet në këtë listë.**

**Kryetari i Komunës-** një njoftim shtesë, ndërmarrja publike që menaxhohet prej komunës së Prishtinës që titullohet kuzhina SHA, jemi në negociim me ta që me ofruar një filial në territorin e komunës tonë që ka me i furnizuar për ne me ushqim të gatshëm çerdhet publike. Duke pasur parasysh furnizimin me material të dobët që e kam cekur edhe gjatë fushatës dhe duke ditur që pjesa e furnizimit është pjesë e kontratës së nivelit qendror. Ne si komunë kemi të drejtë vetëm të bëjmë porosi të artikujve. Për neve sigurisht kjo që sapo thashë është një avantazh i madh duke pasur parasysh edhe kualitetin e ushqimit, e pastaj të kursimit sepse pastaj nuk kemi nevojë më për furnizim prej kontratës qendrore, e sidomos krijimin e vendeve të punës në kuadër të asaj ndërmarrje pasi që të themelohet në komunën tonë.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Lulzim Shoshi.

**Lulzim Shoshi-** kam nevojë për më shumë sqarim Kryetar! E para ajo ndërmarrje a ishte e Prishtinës? A është ideja të formohet një ndërmarrje e njëjtë në komunën tonë, apo vjen ajo nga Prishtina dhe i furnizon çerdhet këtu?

**Kryetari i Komunës-** neve ligji për bashkëpunim komunal na lejon bashkëpunimin në projekte që janë të interesit publik, kemi pasur bashkëpunime

me komunën e Klinës e me të Pejës, varësisht prej natyrave të projekteve që i kemi pasur. Në të njëjtin ligj thirremi edhe kur bëjmë marrëveshje me këtë ndërmarrje, ajo ndërmarrje e hap një filial në komunën e Istogut, sigurisht që është ndërmarrje profitabile njëjtë sikur "Ambienti" njëjtin statut e ka. Por mbi të gjitha e rëndësishme është që fëmijët tanë në çerdhe publike hanë ushqim të freskët dhe produkte që janë të kontrolluara prej nesh dhe prej inspektorëve.

**Kryesuesi i Kuvendit-** faleminderit Kryetar! Fjalën e ka Liridona Lajçi.

**Liridona Lajçi, LDK-** pyetjet tona në këto raste kur kërkesat janë siç e ceku drejtori pak me vonesë, nuk e thashë që janë jashtë afatit, vetëm më intereso i çfarë konsiderohet me vonesë. Ne jemi për, për të gjitha pronat që janë në të mirë të qytetarëve dhe bizneseve. Faleminderit!

**Kryesuesi i Kuvendit-** Kryetari i Komunës e ka fjalën.

**Kryetari i Komunës-** me sa kam unë informacion, nuk ka ndonjë afat të përcaktuar të dorëzimit të kërkesave, afat ligjor po mendoj, nuk ka që përcakton afatin kur një fermer apo biznes ka të drejtë me dorëzuar kërkesën. Afatin ligjor neve na përcakton kur kemi të drejtë me e shqyrtuar dhe miratuar listën.

**Kryesuesi i Kuvendit-** a e dëshiron edhe dikush fjalën. Bedri Haxhiu e ka fjalën.

**Bedri Haxhiu, LDK-** përshëndet të gjithë të pranishmit! Nëse duhet me i heq pronat, e kam edhe një tjetër problem, e kemi pronën te FSK-ja është parcela me numër 0099-14 me një hektar e 21 ari që komplet e përfshinë pjesën para FSK-së që nuk ka logjikë me dalë kjo atëherë po e heqim edhe këtë. Pastaj parcela tjetër 0099-11 një hektar e 93 ari është saktë parcela ku është vendosur gur themeli i fabrikës për prodhimin e barnave edhe kjo duhet të hiqet. Këto prona duhet të rishikohen edhe njëherë dhe para se të dalin në ankand e ato që janë me interes mos të dalin. E ke edhe parcelën 3119, d.m.th nuk janë 59 parcela në total pra e ke një parcelë në Rakosh që ka dalë dy herë, besoj është gabim teknik.

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Lulzim Shoshi.

**Lulzim Shoshi-** edhe njëherë për këtë parcelën në Kashicë, është propozim i imi, së paku pjesën ku është shkolla dhe oborri i shkollës, le të jetë pjesë e fshatit, e pas shkollës e andej është arë le te punon kush ta marrë.

**Kryetari i Komunës-** jam i detyruar me e përkrahur propozimin e Hajrushit, duke marrë parasysh edhe përvojën e tij si anëtar i Kuvendit të asaj ane, njëkohësisht po e përkrahim edhe propozimin e Lulzimit. E sa i përket diskutimit të Bedriut ligji nuk lejon me bërë gabime. E para është Plani Zhvillimor Komunal i dyti është Harta Zonale e treta perimetri i bazës së Forcës së Sigurisë së Kosovës që nuk të lejon edhe nëse ti do si komunë. Janë pjesë të shképutura të këtyre parcelave që jepen në shfrytëzim.

**Kryesuesi i Kuvendit-** A ka edhe dikush diçka? pasi që jo hedh në votim edhe propozimin e Hajrush Shoshit që pjesa e shkollës me infrastrukturë të përjashtohen nga kjo ngastër?

**Konstatojmë që nga 17 anëtarë të pranishëm me 17 vota për 0 kundër 0 abstenime miratohet propozimi i anëtarit të Kuvendit z. Hajrush Shoshit që prona e shkollës me infrastrukturë mos të përfshihet në dhënien në shfrytëzim të kësaj prone.**

Po e hedh në votim komplet, kush është të votohet lista e veçantë edhe e përgjithshme e pronave të paluajtshme të komunës me propozimin e Hajrushit dhe propozimet e drejtorit?

**Konstatojmë që nga 17 anëtarë të pranishëm me 17 vota për 0 kundër 0 abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.**

**Shqyrtimi i pikës 21.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** materialin e keni marrë, por unë obligohem që për shkak të mbledhjes së paradites sot që të bëj një sqarim. Për atë që u diskutua ka qenë “të ndryshme” dhe jo “pyetje dhe përgjigje” këto dallojnë shumë dhe kemi rënë dakord që në raste ku ka pika të veçanta, mund t’i propozoni, kemi me votuar çdo gjë që është në interes të qytetarëve. Hap debatin rreth kësaj pike? Fjalën e ka Abetare Sutaj.

**Abetare Sutaj LDK-** sa i përket kësaj pike, propozoj që në Planin e Punës së Kuvendit për vitin 2026 të përfshihet si pikë e rregullt edhe shqyrtimi mujor i kërkesave të qytetarëve të paraqitura përmes përfaqësuesve d.m.th përmes neve me këto arsye: disa nga kërkesat e qytetarëve kanë karakter urgjent dhe si të tilla kërkojnë trajtim të menjëhershëm pa vonesa ndonjëherë edhe të panevojshme. Shqyrtimi mujor i kërkesave besoj që ka me e mundësuar reagim më të shpejt institucional dhe zgjidhje më efikase për këto kërkesa që i parashtrojnë qytetarët. Një arsye tjetër është që me u siguruar trajtimi i barabartë i kërkesave dhe të shmanget grumbullimi i panevojshëm i atyre kërkesave dhe mos me u prit vetëm dëgjimet buxhetore sepse nganjëherë nuk po janë shumë efikase edhe pse e di që janë me rregull që dëgjimet të mbahen, por këto munden me qenë disa prej arsyeve pse po e bëj këtë kërkesë për me e përfshirë në Planin e Punës së Kuvendit për vitin 2026. Faleminderit!

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Kryetari i Komunës.

**Kryetari i Komunës-** sa për informim, paraqitja publike e kërkesave që qytetarët ja u drejtojnë juve nuk nënkupton që janë paraqitur te ekzekutivi për trajtim, nënkupton vetëm publikimin e kërkesave që i drejtojnë tek ju që me ja u

lehtësuar juve e para dhe ata me pas të adresuar kërkesën ju kisha sugjeruar që ata qytetarë që ju drejtohen me kërkesa që kanë të drejtë të plotë për shkak se jeni përfaqësues të tyre me i orientuar në dikasteret përkatëse.

**Abetare Sutaj,LDK-** unë kam shumë ankesa dhe vërejtje prej qytetarëve realisht që nuk po kanë mundësi dhe ka disa raste që nuk kanë mundësi me i takuar drejtorët për me i paraqitur ato kërkesa urgjente. Për këtë arsye e bëra atë propozim, nuk është diçka e keqe, është mirë me i marrë parasysht pak sugjerimet.

**Kryetari i Komunës-** faleminderit prapë Abetare. Por po më duket që nuk më ke kuptuar. Me e paraqitur një kërkesë nuk nënkupton që ke nevojë me e takuar drejtorin. Nënkupton që ke nevojë me ju drejtuar zyrës për shërbim me qytetarë ku ai e përpilon kërkesën që e ka në raport me problemin që mendon që mundemi me ja zgjidh. Ato kërkesa pothuajse në secilën mbledhje të bordit trajtohen publikisht bashkë me të gjithë drejtorët. Kur ne bashkë me ta vlerësojmë që janë urgjente reagimi është i menjëhershëm se kemi edhe kontrata urgjente, kur vlerësojmë se presin planifikimin, reagimi është sipas planifikimit. Të siguroj se te Zyra për Shërbim me Qytetarë brenda dite paraqiten 200-300 kërkesa të natyrave të ndryshme.

**Abetare Sutaj,LDK-** këtë e bëra për korrektësi dhe kuptohet për qytetarëve pasi që jam pajtuar me ta. E thashë është mirë me i marrë sugjerimet për mirë jo si diçka negative meqenëse edhe na përcjellin e marrin edhe përgjigjen.

**Kryetari i Komunës-** prapë nuk më ke kuptuar Abetare. Kërkesat që drejtohen prej qytetarëve te ti nuk marrin përgjigje të menjëhershme. Kërkesat nuk shqyrtohen publikisht, ato munden me u publikuar. Andaj edhe unë po të sugjeroj që ata qytetarë t'i orientosh që t'i parashtrojnë këto kërkesa pranë dikastereve tona përkatëse.

**Kryesuesi i Kuvendit-** a ka edhe dikush diçka? Pasi që jo hedh në votim Planin e Punës së Kuvendit për vitin 2026? Kush është për?

**Konstatohet që nga 17 anëtarë të pranishëm me 17 vota për 0 kundër 0 abstënime miratohet Plani i Punës së Kuvendit për vitin 2026.**

**Shqyrtimi i pikës 22.**

**Kryesuesi i Kuvendit-** fjalën e ka Kryetari i Komunës.

**Kryetari i Komunës-** deri më tash ka funksionuar Agjencioni për Zhvillim Rajonal që ka qenë Organizatë joqeveritare që ka funksionuar nëpër rajonet e Kosovës. Ne kemi qenë anëtarë të Agjencionit Zhvillim Rajonal Perëndim që funksionon në Pejë. Tani me ndërprerjen e projektit prej Bashkimit Evropian,

ministraria e Zhvillimit Rajonal i ka marrë këto Agjencione dhe i ka kthyer në Qendra të Zhvillimit Rajonal. I bie që duhet të ri aplikojmë dhe me e pasur autorizimin unë si Kryetar i Komunës që ato Qendra me vazhduar punën e tyre se janë qendra që bëjnë punë të madhe në drejtim të përfitimit të projekteve që vijnë prej donatorëve të huaj e që funksionojnë në këtë rast e jona me seli në Pejë e nëpër regjione të ndryshme të Kosovës varësisht prej selive që i kanë nëpër qytete. Praktikisht me e marrë autorizimin që me e kthyer prej Agjencionit për Zhvillim Rajonal në Qendër të Zhvillimit Rajonal që tani funksionin në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal.

**Kryesuesi i Kuvendit-** kush është për e hedh në votim?

**Konstatohet** që nga 16 anëtarë të pranishëm me 16 vota për 0 kundër 0 abstenime miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

**Kryesuesi i Kuvendit-** e shpallë të mbyllur mbledhjen e sotme. Falënderon të gjithë për durimin që patën, dhe kontributin e dhënë, Faleminderit për pjesëmarrje, mirupafshim në mbledhjet e tjera.

**Mbledhja përfundoi me punë në ora 16:00**

**Procesmbajtëse,  
Vjosa Hysenaj**

**Kryesuesi i mbledhjes,  
Enver Rugova**

